



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
SEKTORI I FINANCËS

Nr. 42/12 Prot.

Tiranë, më 25.02 2020

Drejtuar : **MINISTRISË SË FINANCAVE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MONITORIMIT DHE MENAXHIMIT TË BUXHETIT

TIRANË

Lënda: **Mbi raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2019.**

Në mbështetje të Ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9 , datë 06.02.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Udhëzimit nr 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të vitit 2019 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit të vitit 2019 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për frymën bashkëpunuese,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

LULJETA NANO



PËRMBAJTJA

<i>-Hyrje.....</i>	<i>3.</i>
<i>-Raport i monitorimit të buxhetit të KLSH-së i vitit 2019.....</i>	<i>3-4</i>
<i>-Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së i vitit 2019.....</i>	<i>5-7</i>
<i>-Analiza e objektivave institucionale të KLSH-së, referuar buxhetit të orientuar në rezultate.</i>	
<i>-Mbi realizimin e objektivave të menaxhimit institucional.....</i>	<i>7-16</i>
<i>-Aneksi Nr 1- Raporti i shpenzimeve sipas Programeve.....</i>	<i>17</i>
<i>-Aneksi Nr 2- Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë.....</i>	<i>18</i>
<i>-Aneksi Nr 3- Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit.....</i>	<i>19</i>
<i>-Aneksi Nr 4- Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.....</i>	<i>20</i>
<i>-Aneksi Nr 5- Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.....</i>	<i>21</i>

HYRJE

Monitorimi i buxhetit të vitit 2019, paraqet vlerësimin e performancës së fondeve buxhetore në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të politikës së institucionit të KLSH-se.

Monitorimi i treguesve buxhetore ka synuar në ndjekjen në vijimësi të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet statusi i realizimit të produkteve kryesore, niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Në mbështetje të Ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr 9 datë 06.02.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar , udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, si dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2019, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-SE”

Politika buxhetore e KLSH-se është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik, 2018-2022, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara nga DG Budget, në kuadrin e Integritimit Europian.

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2019-2021 dhe është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikën e Programit.

Përgjatë vitit 2019 KLSH vijoi me ushtrimin e veprimtarisë institucionale në përmbushje të objektivave prioritare strategjike të zhvillimit institucional, që konsistojnë në:

- 1. Rritja e impaktit të punës audituese me fokus në 6E-të.*
- 2. Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.*
- 3. Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit.*

Përsa i përket kërkesave buxhetore, duke vlerësuar dhe gjendjen aktuale financiare, menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike që KLSII ka programuar në harkun kohor 2020-2022 në planin strategjik institucional në drejtimet e mëposhtme:

- Konsolidimi i Auditimit të Perputhshmerisë vlerësuar sipas kërkesave ISSAI-ve
- Kryerja e auditimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (certifikimi i pasqyrave financiare) dhe shtimi i numrit të auditimeve financiare.
- Fokusi në rritje drejt auditimit të performancës, duke synuar rritjen e numrit dhe të cilësisë të auditimeve të performancës, në funksion të arritjes së parametrave të SAI-ve homologe, shtimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për këtë lloj auditimi, etj.
- Thellimi në auditimin e teknologjisë së informacionit shtimi i numrit të auditimeve IT dhe konsolidimi i cilësisë nëpërmjet zbatimit të Standarteve Ndërkombëtare ISSAI.
- Rritjen e performancës së veprimtarisë audituese përmes forcimit të kapaciteteve institucionale të KLSH, dhe ndjekjes së Programit vjetor zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Optimizimi i kapacitetëve profesionale dhe përmirësimi i metodologjive të auditimit, duke zhvilluar dhe metodologji të veçanta, si ajo e auditimit të mashtrimit financiar, auditimit të inovacionit etj.
- Nxitja dhe promovimi i vlerave të larta profesionale të audituesve nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve.
- Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet zhvillimit të metodologjive publikimeve të manualeve dhe standardeve profesionale të aplikueshme në përputhje me praktikën më të mirë të komunitetit të INTOSAI-t.
- Zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.
- Zhvillimin dhe kualifikimin e burimeve njerëzore konform implementimit të Dokumentit të Politikës së Burimeve Njerëzore në KLSH miratuar me Vendim të Kryetarit nr 128 datë 31.12.2017 .
- Rritjen dhe konsolidimin e cilësisë së botimeve me materiale që i shërbejnë procesit të auditimit etj.

**“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE
PËR VITIN 2019”**

Në zbatim të Ligjit 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, është bërë miratimi i çeljes së fondeve buxhetore për vitin 2019 për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për 2019 paraqiten si më poshtë:

000/leke

Grupi	24	Kodi	1024001
Programi	Veprimtaria Audituese e K.L.Sh.	Titulli	1120

Artikulli	EMERTIMI ARTIKULLIT	BUXHETI PLAN FAKT			Diferenca	Ne % Realizim VJETOR
		Buxheti fillestar vjetor	Plani	Fakti		
Kodi		2019	Janar – Dhjetor i rishikua r 2019	Janar- Dhjetor 2019		
1	2	3	4	5	4-5	5/4
600	Paga	260.600,00	260.600	256.179,8	4.420,2	98%
601	Sigurime Shoqërore	46.300,00	46.300	39.925,7	6.374,3	86%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	90.850,00	90.850	79.462,8	11.387	87 %
605	Transferta Korente të Huaja	150,00	150	117,2	32.8	78%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1.200,00	1.200	1.133,2	67	94%
Totali	Shpenzime Korrente	399 100,00	399.100	376.818,8.	22.281	94%
230+231	Investime me Financim të brendshëm	20.000,00	20.000	190	19.810	10%
Totali	Shpenzime Kapitale	20.000,00	20.000	190	19.810	10%
Totali	Korrente dhe Kapitale	419.100.00	419.100	377.008.9	42.091	90%

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR 12-MUJORIN E VITIT 2019

Shpenzime Korrente

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2019 për zërin Paga dhe Sigurime është 306,900 mijë lekë, nga të cilat:

-Pagat nga 260 600, mijë lekë të planit vjetor janë shpenzuar në vlerën 256,179 mijë lekë ose 98. % e planit vjetor 2019.

-Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga 46,300 mijë lekë të planit vjetor janë shpenzuar në vlerën 39.925 mijë lekë ose 85.9 % e planit vjetor 2019.

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar komform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera Operative .

Fond i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2019 është 90.850 mijë lekë, ku fond i planifikuar për Shpenzime për Mallra dhe Shërbime, për periudhën Janar- dhjetor 2019 është shpenzuar në masën 79.462 mijë lekë. Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative te shpenzimeve si shpenzime për drita, ujë, telefon etj. Në këtë artikull jane kryer shpenzimet për trajnime jashtë dhe brenda vendit dhe për dieta në funksion të veprimtarisë audituese. Organizimi dhe pjesëmarrja në këto aktivitete janë shoqëruar me kostot përkatëse duke u fokusuar në menaxhim sa më të kujdesshëm dhe përdorim sa më me efektivitet. Në këtë zë shpenzimesh përballohet dhe shpenzimi per mirëmbajtjen e sistemit te auditimit,si dhe shpenzime transporti etj.

Nje pjese te konsiderueshme ne shpenzimet operative zë shpenzimet per udhëtim e dieta brenda vendit.

3-Transferta korrente dhe të huaja.

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2019, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 117 mijë lekë nga 150, mijë lekë të planifikuara.

4-Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, është dhënë Fond i Veçantë me kërkesat e bëra nga ana jonë dhe të konfirmuara nga Ministria e Financave në vlerën 1200 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast sëmundjeje dhe është realizuar në masën 1.133 mijë lekë.

5-Shpenzime për investime kapitale.

Bazuar në Ligjin nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale ishte në shumën 20.000 mijë lekë nga të cilat 20,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm

Shpenzime për Investime Kapitale

1-Financim i Brendshëm

/000 Lekë

Emertimi i Projektit / Financim i Brendshëm	Plani sipas Ligjit	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca
Blerje paisje kompjuterike	10.000,00			10.000,00
Pajisje te ndryshme zyre	300,00		190	110,00
Blerje automjete	9.700,00			9.700,00
Totali	20.000,00		190	19.810,00

--Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në blerje "Automjete", blerjen e 3-automjeteve, për plotësimin e nevojave për automjete në vlerën 9,700 mijë lekë. Ky produkt nuk është realizuar nga Agjensia e Blerjeve të përqendruara si institucioni i autorizuar për kryerjen e ketyre procedurave për këtë kategori aktivi.

- Blerje pajisje kompjuterike. Fondi vjetor i detajuar është 10,000 mijë lekë. Ky fond nuk u prokurua brenda vitit 2019, nga AKSHI si institucion i autorizuar për kryerjen e prokurimeve për këtë kategori aktivi.

- Blerje paisje zyresh ,fondi i planifikuar në këtë zë është 300 mijë lekë. Për 12-mujorin në këtë zë janë kryer shpenzime në vlerën 190 mijë lekë, Në këtë zë shpenzimesh janë blerë : Banak arkive, derë arkive , karrige , korniza etj.

Theksojme që përgjatë 12- mujorit 2019 KLSH nuk ka patur ndryshim të planit fillestar të buxhetit alokuar me Ligjin " për buxhetin e vitit 2019"

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TË KLSH-SË, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PËR PERIUDHËN 12/MUJORIN E VITIT 2019

KLSH përgjatë vitit 2019 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirefunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

1.MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në katër nene të saj ka qartësisht të shprehur misionin dhe nivelin pavarësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat formëzojnë identitetin institucional të tij. Ky mision dhe funksionimi institucional janë strukturuar dhe sanksionuar në detaje në Ligjin nr.154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", mbi bazën e të cilave janë ndërtuar të gjitha aktet rregullative institucionale dhe metodologjike të institucionit.

Vizioni i KLSH-së

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.

Në përmbushje të kërkesave ligjore, standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të institucioneve supreme të auditimit të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t si dhe akteve rregullatore, KLSH kryen auditime financiare, të përputhshmërisë, të rregullshmërisë, të performancës, të teknologjisë së informacionit, si edhe ndërmerr vlerësime të sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit dhe njësive të auditimit të brendshëm të strukturave qeverisëse dhe enteve të tjera publike.

Misioni i KLSH-së

KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që ti shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

KLSH ka funksionuar do të vazhdojë të veprojë si një agjent ndryshimi, në shërbim të qytetarit dhe të qeverisjes së mirë , duke reflektuar vlerat dhe parimet e një SAI modern, anëtar i komunitetit të INTOSAI-t i udhëhequr nga motoja “*Të gjithë të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri*”

Vizioni shkon përtej qasjes tradicionale të fokusuar në vlerësime dhe konstatime. Audituesit e jashtëm publikë e realizojnë aktivitetin e tyre jo vetëm duke vepruar por duke bashkëvepruar nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillimeve të subjekteve publike të audituara për të maksimizuar vlerën e parasë publike.

Misioni dhe vizioni orientojnë mënyrën sesi institucioni duhet të performojë për të: garantuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësive të tjera të sektorit publik; nxitur llogaridhënien para Parlamentit dhe rritur transparencën për qytetarët; duke qenë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmbush misionin dhe realizon veprimtarinë në zbatim të tetë parimeve: Pavarësia; Profesionalizmi; Bashkëpunimi; Përgjegjshmëria; Bashkëpunimi; Përgjegjshmëria; Integriteti; Objektiviteti; Interesi Publik; Transparenca

Zhvillimi i KLSH mbështetet në Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Institucionit të miratuar nga Kryetari KLSH me Vendimin nr date per periudhen 2018-2022. Ne kete strategji KLSH ka përcaktuar Misionin dhe vizionin institucional te se ardhmes. Objektivi i ISSAI-t 12, sipas të cilit *“SAI duhet të jetë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit”*, përbën boshtin mbi të cilin është hartuar Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së dhe që synon të sigurojë: transparencën dhe përgjegjshmërinë e duhur; qeverisjen e mirë; pajtueshmërinë me Kodin e Etikës; ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet promovimit të të mësuarit dhe shpërndarjes së njohurive.

Tri qëllimet strategjike, në të cilat KLSH e ka fokusuar veprimtarinë e saj pëedhe per kete 4 mujor dhe që konsistojnë në:

- 1-Qellimi 1. Rritja e impaktit te punes audituese me fokus ne 6 E-te.
- 2-Qellimi 2. Optimizimi i kapaciteteve profesionale aftësive audituese procedurave te punes logjistikes dhe funksioneve te tjera mbeshtetese.
- 3-Qellimi 3 Per miresimi i kanaleve te komunikimit dhe bashkëpunimit.

Objektiv i vazhdueshëm i *KLSH-së* është të jetë një faktor profesional aktiv dhe partnere për fuqizimin e mirëqeverisjes financiare dhe llogaridhënies publike në funksion të promovimit të transparencës, efijencës dhe efektivitetit. Në këtë kuadër thellimi i luftës kundër korrupsionit është në fokus të veprimtarisë institucionale.


Edhe gjatë vitit 2019, objektivat institucionale ne te cilin fokuson aktivitetit KLSH-së, konsistojnë në:

- Sfida për orientimin e auditimit bazuar në riskun e gabimeve, mashtrimit dhe korrupsionit është adresuar nëpërmjet zhvillimeve dhe përmirësimeve të metodologjisë, duke u përqendruar në auditimin e sektorëve të ekonomisë me ekspozim më të lartë ndaj këtyre risqeve.
- Konsolidimi dhe rritja e numrit të auditimeve të performancës përmes zgjerimit të temave të fokusimit dhe të rritjes graduale të kapaciteteve profesionale dhe numerike të departamentit.
- Zhvillimi i auditimeve financiare, dhënia e opinionit për pasqyrat financiare si një hap më tej drejt përmbushjes së objektivit për rritjen e numrit të auditimeve financiare.
- Konsolidimi dhe modernizimi i qasjes për auditimet e përputhshmërisë në të njëjtën linjë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.
- Rritja e cilësisë dhe e numrit të auditimeve IT, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të auditimit IT.
- Rritja e shkallës së përdorimit të infrastrukturës dhe mjeteve të IT gjatë procesit auditues ishte një nga objektivat në të cilat ka qenë përqendruar menaxhimi institucional përgjatë vitit 2019, por që mbetet sfidë edhe për vitin 2020.
- Rritja e besueshmërisë tek institucioni suprem i auditimit, vlerësuar nga perceptimi i qytetarëve është një tregues se auditimet dhe raportimet janë kryer me integritet dhe profesionalizëm të lartë.

MBI VEPRIMTARINË AUDITUESE TË KLSH-SE PER VITIN 2019

TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

Për periudhën janar – dhjetor 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit nga 151 auditime të planifikuara ka kryer 160 të tillë, nga të cilët ka përfunduar dhe evaduar 140 dhe 20 auditime janë në proces.



Për vitin 2019, Drejtoria e Auditit të Brendshëm² në KLSH ka realizuar 5 auditime nga të cilat 4 i ka përfunduar dhe 1 është në proces auditimi.

SHKELJET ME DËM EKONOMIK



Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej **27,304,777 mijë lekë** ose **223,8 milionë euro**.



Indikatori i dobisë së auditimit (raporti i dëmeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH në vlerën 27,304,777,000 lekë (223.8 milionë euro) me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 377,008,979 lekë) është 72,4.




Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej **130,511,594 mijë lekë**, afërsisht **1,069 milionë euro** nga e cila

I. **46,632,192 mijë lekë** në fushën e të ardhurave, afërsisht **382 milionë euro**;

¹Katër Auditimet e Brendshme nuk përfshihen në statistika

II. 83,879,401 mijë lekë afërsisht 687 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.



Puna audituese është përqëndruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Edhe këtë vit, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe inefficiencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe shkeljet në zbatimin e legjislacionit fiskal.

A.Përmbledhëse e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve

Tabela nr.1

I. Dëm ekonomik në të ardhura	000/lekë
Nga Shkeljet në Zbatimin e Legjislacionit Tatimor	113,650
Nga Shkeljet në Zbatimin e Kodit Doganor	959,514
Nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qera, marrëveshjet hidrokarbure dhe kontratat koncensionare	20,640,915
Të tjera	3,397,540
Totali i Dëmit ekonomik në të ardhura	25,111,620
II. Dëm Ekonomik në shpenzime	000/lekë
Në Shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	8,028
Në Shpenzimet Operative	416,013
Në Shpenzimet për Investime	1,678,989
Të tjera	90,127
Totali i Dëmit ekonomik në shpenzime	2,193,158
	27,304,777
 Totali i dëmit ekonomik (I+II) = 27,304,777 mijë lekë ose 223,8 milionë euro	

B.Të ardhura apo shpenzime të realizuara në kushtet e parregullsive në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi dhe në fushën e shpenzimeve me efekte negative për periudhën janar – dhjetor 2019.

Tabela nr.2

I.	Efekte Negative në të Ardhurat e Buxhetit	000/lekë
1	Nga Shkeljet në Zbatimin e Legjislacionit Tatimor	42,105,458
2	Nga Shkeljet në Zbatimin e Kodit Doganor	3,329,415
3	Nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qera, marrëveshjet hidrokarbure dhe kontratat koncensionare	256,914
4	Të Tjera	695,848
5	Urbanistika	244,557
	Totali	46,632,192

II.	Efekte Negative për Shpenzimet e Buxhetit	000/lekë
1	Në Shpenzimet për Paga, Sigurime dhe Shpërblime	348,911
2	Në Shpenzimet Operative	24,334,774
3	Në Shpenzimet për Investime	50,487,166
4	Të tjera	8,708,550
	Totali	83,879,401
	Totali i efekteve negative në të ardhurave dhe shpenzime (I+II)	130,511,594


INSTITUCIONET KU JANË USHTRUAR MISIIONET E AUDITIMIT

Auditimet janë kryer në një numër të konsiderueshëm prej 192 subjekte. Auditimet janë shtrirë në institucione qendrore dhe njësi të varësisë për të patur një mbulim të kënaqshëm dhe për të garantuar një sistem menaxhimi financiar dhe kontrolli sa më efektiv. Këtu përfshihen ministritë dhe agjencitë (drejtori qendrore dhe rajonale) në varësi të tyre, organet e sistemit fiskal, shoqëritë aksionere me kapital shtetëror, në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki, komuna) si dhe projekte me financim të huaj, duke mbuluar të gjitha ciklin e veprimtarisë së tyre (të ardhurat dhe shpenzimet), ku 32% e tyre kanë qenë të përfshirë në auditimet e performancës.

Tabela nr.3 Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Auditimet e KLSH-së janë ushtruar në këto institucione:	Nr
☞ Institucionet te qeverisjes qendroreqendrore	26
☞ Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	31
☞ Institucione te tjera financiare , Ministria e Financave dhe Ekoniomise ,dhe institucionet e varesise	14
☞ Shoqwrite publike dhe projektet me financime të huaja	23
☞ Institucionet e administrimit te asetëve dhe mbrojtjes se mjedisit	23
☞ Subjekte nw te cilat janë kryer auditime te IT	17
☞ Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performancës	58
TOTALI I SUBJEKTEVE	192

Grafik nr.1 Subjektet e audituara në periudhën Janar – Dhjetor 2019



KLSH DHE KUVENDI

Në bazë të detyrimeve të ndërsjella kushtetuese midis dy institucioneve, KLSH për vitin 2019, i ka përcjellë Kryetarit të Kuvendit Raportet dhe Vendimet e Kryetarit të KLSH-së për 135 auditime të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Marrëdhënia dhe raporti institucional i KLSH-së me Kuvendin, në shërbim të interesit publik, ndërlihet ngushtësisht dhe kryesisht me Komisionin për Ekonominë dhe Financat, por edhe me Komisione të tjera, në funksion të tematikës që trajtojnë auditimet tona. Për këtë arsye, Vendimet/raportet e auditimit i janë përcjellë kryesisht Komisionit për Ekonominë dhe Financat por edhe Komisioneve të tjera të Kuvendit, referuar fushës që mbulojnë.

BOTIMET E KLSH-së PËR VITIN 2019

Gjatë vitit 2019, KLSH ka vijuar botimin e librave të kolanës së KLSH-së, duke i shtuar 102 botimeve të viteve 2012-2018, 11 botimet e 2019, me titujt e mëposhtëm :


- Performanca e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2018 (në shqip dhe në anglisht);
- Revista Kërkimore-Shkencore, “Auditimi Publik” (Nr.21,Nr.22 dhe Nr.23);
- Manuali i Auditimit të Prokurimit Publik;
- ... 3 Vjet Auditim i Jashtëm Publik ;
- Rregullorja e procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve
- Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm (vëllimi XXII)

- Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm (vëllimi XXII)
- Konferenca Young ALSAI 2019;
- GAO, NIK –Leksionet e Dodaros

REKOMANDIMET SIPAS NATYRËS

KLSH, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara. Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore, organizative, masa administrative dhe disiplinore gjithsej janë 3441, nga të cilat: 100 janë përmirësime ligjore, 713 masa rekomandime disiplinore dhe administrative dhe 2628 rekomandime organizative.

Masat e rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar- Dhjetor 2019



Burim KLSH

Mbi Zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe të forcimit të kapaciteteve të trupës audituese. Trajnimet e kryera.

Sipas synimeve të projektuara në kërkesat e Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 258, datë 31.12.2018, mundësoi që çdo auditues në KLSH përgjatë v.2019 të arrijë objektivat dhe realizojë indikatorët themelorë që nxisin forcimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimit.

Gjatë vitit 2019, karakteristikë është se janë alternuar në mënyrë të harmonishme të dy opsionet e mundshme, sipas vendit të kryerjes së seancave të konsolidimit të njohurive:

- Seminare dhe trajnime të zhvilluara në institucionin e KLSH-së me lektorë vendas dhe të huaj;
- Seminare dhe trajnime të zhvilluara në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë pranë SAI-ve dhe Gjykatave të Auditimit.

Trajnimet e organizuara brenda institucionit janë fokusuar kryesisht në tre blloqe kryesore:

1. *Trajnime për stafin e ri*, me bosht kryesor prezantimet dhe njohuritë mbi rolin dhe përgjegjësitë e institucionit suprem të auditimit, dhënien e njohurive dhe koncepteve

themelore mbi përgjegjshmërinë, llogaridhënien publike dhe misionin e profesionistëve të auditimit publik; aftësitë dhe mjeshtritë që ata duhet të zotërojnë; teknikat dhe mjetet që duhet të përdorin gjatë punës së tyre etj,

2. *Trajnime të përditësimit të njohurive*, të cilat janë drejtuar për stafin ekzistues dhe me eksperiencë, kryesisht në formën e analizës së rasteve studimore (case study); shkëmbimit të eksperiencës brenda departamenteve nëpërmjet komunikimit të gjetjeve dhe rekomandimeve për auditimet më të vlerësuara; si dhe ofrimin e trajnimeve nga partnerët ndërkombëtarë dhe lokalë, të organizuara gjatë gjithë vitit 2019. Ky grup trajnimesh intensive ka përfshirë dy fasha mujore: trajnime të realizuara gjatë muajit gusht 2019 dhe ato të kryera gjatë periudhës shtator-nëntor 2019,

Në fund të vitit 2019, audituesit e KLSH kishin siguruar një mesatare prej 25 ditë trajnimi /auditues, duke shënjestruar një nivel të lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite, që nga krijimi i tij.

Në referencë të procedurave analitike krahasimore, indikator i numrit të ditë trajnimeve për çdo auditues mesatar vjetor rezulton të jetë 14,5 herë më shumë se viti 2009 ku regjistroheshin vetëm 2 ditë mesatare trajnimi / auditues.

Trajnimet dhe kualifikimet jashtë vendit:

Këto aktivitete kanë shtuar mundësitë e kontakteve dhe përfitimeve direkte nga shkëmbimi i përvojave gjatë vitit 2019 dhe ku ndoqën aktivitete kualifikimi 79 auditues dhe janë realizuar 258 ditë trajnimi jashtë vendit në 2019.

Vetëm në intervalin kohor 2015-2019, nga ana e KLSH-së janë ndjekur 264 aktivitete jashtë vendit, me 2993 ditë trajnimi gjithsej për këto pesë vite si vizita zyrtare, ërkshop-e, marrëveshje bashkëpunimi me institucionet analoge evropiane dhe më gjerë, komitete të kontaktit, tryeza të grupeve të punës, konferenca shkencore dhe seminare trajnuese, vizita studimore në SAI-t homologe, etj..

Në zbatim të politikave të zhvillimit profesional, bazuar në marrëveshje dhe marrëdhënie me institucionet ndërkombëtare të auditimit, gjatë periudhës 2013-2019, është përfituar përvojë nga programe internship-i prej 6 audituesve për periudha afatgjat në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), Luksenburg. Meriton të thuhet se, numri i audituesve dhe nga 1 auditues i KLSH është ndjekur cikli i trajnimeve (felloëship) pranë GAO-s.

Indikatorët sintetike trajnimeve të periudhës 1 Janar 2019-31 dhjetor 2019.

1. Mesatarja e trajnimeve të realizuar për auditues gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019: 25 ditë trajnimi për auditues.

2. Në total janë realizuar gjatë vitit 2019, 3611 ditë njerëz trajnime brenda dhe jashtë vendit.

Bashkëpunimi me SAI-et partnere dhe institucione të tjera ndërkombëtare për vitin 2019

Të udhëhequr nga motoja e INTOSAI-t “*Experientia mutua omnibus prodest*” dhe në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022, Kontrolli i Lartë i Shtetit edhe gjatë vitit 2019 ka thelluar bashkëpunimin me institucionet homologe supreme të auditimit. Rëndësi e veçantë i është dhënë përfitimit të eksperiencës dhe thellimit të njohurive të audituesve në fushën e auditimit të performancës, auditimin IT dhe atij financiar si dhe përfitimi i eksperiencës në qasjet e ndryshme të kolegëve në auditimin e rasteve të korrupsionit dhe mashtrimit, përdorimin e Big Data dhe auditimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Mbështetur në sa më sipër, 82 nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë vitit 2019 morën pjesë në 44 aktivitete të zhvilluara jashtë vendit me përkatësisht 258 ditë/njerëz.

Aktivitetet e grupeve të punës dhe task forcë

Përgjatë vitit 2019 KLSH ka marrë pjesë në aktivitetet që janë zhvilluar në kuadër të Grupeve të Punës në të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit është pjesë. Këto Grupe Pune janë

- Grupi i Punës i EUROSAT-t për auditimet IT;
- Grupi i Punës së EUROSAT-t për Auditimin e Fondeve të Alokua për Fatkeqësitë dhe Katastrofat;
- Grupi i Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit;
- Task Forca e EUROSAT-t mbi Auditimin dhe Etikën;
- Task Forca e EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive.

KLSH ne vijim me burimet financiare disponibel do të vazhdojë përpjekjet institucionale të cilat synojnë modernizimin dhe reformimin e institucionit me qëllim që të reflektojmë tiparet dhe standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI dhe fokusimin e veprimtarisë audituese me impakt, forcimin e llogaridhënjes publike, të integritetit, transparencës institucionale.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Luljeta NANO



ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

2019

VITI

Emri i Grupit	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Kodi i Grupit	1024001					
Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit								
Programet		(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2018	(2) PBA Viti _2019	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti-2019	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
Titulli	Emertimi							
01120	Programi Veprintari Audituese e KLSH	404,461.7	383,100.0	419,100.0	419,100.0	419,100.0	377,008.9	-42,091.1
		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali i Shpenzimeve te Ministrise/Institucionit Buxhetor		404,461.7	383,100.0	419,100.0	419,100.0	419,100.0	377,008.9	-42,091.1
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		404,461.7	383,100.0	419,100.0	419,100.0	419,100.0	377,008.9	-42,091.1

Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Luljeta Nano
	Firma	
	Data	23 /02/2020



ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit Programi	Kontrolli i Lartë i Shtetit						Kodi i Grupit	
	Programi Veprimtari Audituese e KLSH						Kodi i Programit	
Art.	Emertimi						(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progresiv 8- Mujsori	(6) Fakti i Pariudhes/progresiv
	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2018	(2) PBA Plan Viti 2019	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2019	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019				(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	234,800.0	260,600.0	260,600.0			256,179.8	-4,420.2
601	Sigurime Shoqërore	37,300.0	46,300.0	46,300.0			39,925.7	-6,374.3
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	90,850.0	90,850.0	90,850.0			79,452.8	-11,387.2
603	Subvencione							0.0
604	Transferta Korente të Brendshme	150.0	150.0	150.0			117.2	-32.8
605	Transferta Korente të Huaja	1,143.1	1,200.0	1,200.0			1,133.0	-67.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	363,100.0	399,100.0	399,100.0			376,818.5	-22,281.5
Non-Totali	Shpenzime Korrente	363,100.0	399,100.0	399,100.0				0.0
230	Kapitale të Patrupezuara	665.2	20,000.0	20,000.0			199.0	-19,810.0
231	Kapitale të Trupëzuara	24,421.5						0.0
232	Transferta Kapitale	25,086.7	20,000.0	20,000.0			190.0	-19,810.0
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	25,086.7	20,000.0	20,000.0				0.0
230	Kapitale të Patrupezuara	13,439.0						0.0
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0
232	Transferta Kapitale	13,439.0	0.0	0.0			0.0	0.0
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	13,439.0	20,000.0	20,000.0			190.0	-19,810.0
Totali	Shpenzime Kapitale	38,525.7	20,000.0	20,000.0			0.0	0.0
Totali (korrente + kapital + Shp nga te ardhjashte limiti)	404,453.1	383,100.0	419,100.0	419,100.0			377,008.5	-42,091.5

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Elina Bregaj	Emri	Luljeta Nano
	Firma	Firma	
	Data 23.02.2020	Data	23.02.2020

Emri i Grupit		Kodi i Grupit	1024001
Programi		Kodi i Programit	1120

Drejtesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Elina Bregaj	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Luljeta Nano
	Firma			Firma	
	Data	02/2020		Data	03/02/2020



ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikave se programit"

Kodi i Programit	1024001	Emertimi i programit:	Veprimtari Auditueses e Kontrollit te Larte te Shtetit					Komente
Qellimi 1	" Ushtrimi i veprimtarise audituese ne nje linje me standardet nderkombetare te auditimit mbi perdorimin me efektivitet, effcencence dhe ekonomicitet te fondeve publike ne funksion te rritjes se pergjegjshmerise se menaxhimit te financave e pasurise publike duke sjelle vlere te shtuar per shoqerine dhe ndryshim ne jeten e qytetareve"							
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances *** /Produktit	Niveli faktik i vitit 2018	Niveli i planifikuar ne vitin 2019	Niveli i rishikuar ne vitin 2019	Niveli faktik ne fund 8- mujorit 2019	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
Objektivi 1.	"Mbulimi me auditime financiare perputhshmerie dhe performance i njesive te sektorit publik nepermjet konsolidimit te auditimeve te perputhshmerise rritjes se auditimeve financiare dhe te performances ne nje linje me Standardet Nderkombetare te Auditimit ISSAI"	A	Auditime te kryera		151	151	140	93%
Objektivi 1.1	Ofrimi i kushteve cilësore të punës për zhvillimin e aktivitetit auditues të KLSH-së nëpërmjet investimit për ngritjen e godinës dhe përmirësimin i infrastrukturës akomoduese me paisje dhe orendi të nevojshme, në funksion të ushtrimit normal të veprimtarisë institucionale.	A	Blerje paisje kompjuterike		6	6	0	0%
		B	Blerje paisje zyre		20	20	19	95%
		c	Blerje Automjete		3	3	0	0%
		d						
		e						
		A						

Drejtuessi i Ekspit Menaxhues iis Programit	Emri	Elina Bregaj	Sekretari i Pergjithshem	Emri	Luljeta Nano
	Firma			Firma	
	Data	25.02.2020		Data	23.02.2020

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2019 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri ne periudhen aktuale	REALIZIMI për periudhen e raportimit (12-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri ne periudhen aktuale	Komente
M240010	Paisje te ndryshme zyre	300	2019	2019		300	190	190	0	
M240009	Blerje paisje kompjuterike	10000	2019	2019		10000	0	0	0	
M240010	Blerje automjete	9700	2019	2019		9700	0	0	0	

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI për periudhen e raportimit (12-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri ne periudhen aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri ne periudhen aktuale	Komente
M240001	Forcimi i kapaciteteve te auditimit te jashtem	Grant/				0	0	0			

Drejtpuesi i Ekipit Menaxhues te Programit	Emri	Elina Bregaj	Emri	Luljeta Nano
	Firma		Firma	
	Data	23/02/2020	Data	23/02/2020

